

KICO, BLUSHI

H - 1

3 - 66

Mirë mëngjer

891.883 - 1

B . 66

KIÇO S. BLUSHI

S

MIRË MËNGJEZ!

(VJERSHA DHE POEMA)

BLIOOTEKA E SHTËPI

ANTR 1981

48581

11491

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

S I K U R . . .

Qielli nis që përtej malesh.

Sikur të ish e mundur që në botë

Të kish muzeume qiejsh,

Unë që larg do tâ njihja

Copëzën shqiptare të qiellit.

ALEKSANDËR MOISI

«Unë zotëroj një çertifikatë qytetari,
të lëshuar nga qeveria e përkohëshme e princ
Vidit».

— A. Moisiu —

1

Në ato vite
(Kur mbretërit luanin me historinë bixhos ,
Kur fashistët stërvitnin ushtarët e
Natës dhe vdekjes)
Shqipëria e jonë,
Me zërin tënd,
Monologun e famshëm botës i thosh:
— Të rrrosh,

apo të mos rrrosh?

2

Përse të duartrokisnin, Aleksandër Moisi ?
Përse të donin ?
Sepse fati yt u rrukullis në dhë të huaj,
Sepse ti, për Shqipërinë, ishe Hamleti vetë,
Sepse ti nuk luaje Shekspirin-askënd,

Por veten,
Fatin tünd
Dhe tonin.

3

Në botë, Aleksandër,
Për artistin ka vetëm një vend — atdheu,
Ku zemra mund të rrahë me puls të rregullt,
Ku njerëzit mund të ta njohin më mirë
 shpirtin.

BABA IT

Kur «Skoda»,
Në baltën e natës bën xhiro,
Merri gjith' vargjet e mia
Dhe nën rrota,
Në vend të gurëve, i hidh...
Sepse të presim...

KËNGË DJEPI E KËNDUAR NË DY KOHË TË
NDRYSHME

I.

Mos u rrit shpejt, o bir
Që koha të zgjatet më shumë...
Nga duart e nënës mös ikësh
Siç ikën nga mali një lumë...

I dëgjon nënët dhe nuset si qajnë?
«Mu në breg të detit
Vaporë ka dalë...
Ku vete, mos vafsh i gjallë?»

Shkojnë djemt e nënave
Shkojnë larg, nizamë...

II

Fli o bir, fli
Të rritesh shpejt, të bëhesh burrë
Nga duart e nënës të ikësh
Siç ikën nga mali një lumë...

I dëgjon partizanët si këndojojnë?
Unë po hesht, o bir,
Që këngën e tyre
Ta dëgjosh më mirë...

P R A N V E R È

Punëtorët s'i kanë firmosur akoma
Fletët e kampit.
Në buzë të detit rri e i gjëzohem
Kuptimit të gjithë jetës —
Fëmijëve.

Gjithmonë të bëjnë të mendosh
Këto valë të përjetëshme,
Ky plazh i heshtur që njeh vetëm
gëzimin e njérëzve.

Ke qejf të jesh gjithmonë i ri,
Si këto valë,
Si kjo lindje e diellit mbi buzët e detit.

B R A M K A

Vdiq Bramka....

Sazexhiu i famshëm që u këndoi
Shtretërve të rinj të nuseve,
Kostumeve të hekurosura të dhëndurëve.

Vdiq Bramka...

Ahere kërkoheshin këngë
Që të mbytnin errësirën e netve të uritura.
Netët trokisnin xhameve të kafeneve
Që baballarët e dehur
Të ktheheshin shtëpive.
Por baballarët e inatosur thërrisinin:
— Bramkë, këngë!
Vetëm këngë!

Vdiq Bramka...

I futi të gjitha këngët në gajde
Dhe iku.
E mori me vehte dhe gajden
Dhe iku.
I mbështolli në shami këngët e kafeneve
Dhe iku.

M I R M È N G J E Z

Mbi Mesdhe
Dielli shtegëtimin e përjetshëm nisi...
Me gëzimin e natyrshëm njerëzor
U flas deteve, grunjëve, gurëve, udhëve:
— Mirëmëngjez!

Ka popuj që ndodhen akoma në natë...
E megjithatë unë ju drejtoj
Këtë të shëndetëshme fjalë:
— Mirë mëngjez! Mirë mëngjez!

STËRNIPËRVE

Çdo këngë që të nisni
Ndër dasma, inaugurime, festivale
Notat e para të këngëve do jenë
Notat partizane.

K O N C E R T

Bethoveni,
Nga partiturat,
Ngriti syt' e pakënaqur të gjeniut
Ngriti zën'e çuditshëm me theks
metalik

Dhe tha:

— Po ti
Pse
S'duartroket?
Mos gabimisht ke ardhur
Këtu,
Në koncert?

Mua
M'u tha pështyma...
Si mund t'i thosha
Se njerën dorë
E kisha humbur maleve?

Si mund t'i thosha
Se «patrioti» i tij
Dorën ma preu
Për mos duartrokitur kurrë?

VITI I RI 1967

Shok, jam
I shqetësuar.
Jo pse më iku një vit,
Jo pse marshoj kështu
Drejt thinjoshes pleqëri...

Por duke kërcyer sonte në pallatin e ri
Mes gëzimeve, urimeve, vajzave
Unë pashë Migjenin që kollej
E griste në qindra copa
«Urimin për vitin e ri
1937.»

MULLIRI I VJETËR

Guri yt,
I rrumbullakët,
Hijerëndë,
si vëtë toka.

Kishte shekuj
Që guri yt i vjetër
Vërtitej në të kundërtin drejtim
Të tokës.

Te ti, mulli,
Fqinji vriste fqinjin,
Babai vriste djalin...
Përse?
Për një grusht misër,
Për një grusht grurë,
Për një grusht miell...
Te ti, mulli,

Kryqëzohej jeta me vdekjen,
Vdekja me jetën...

Tani, veç Don Kishoti
Në u ktheftë te ti, mulli i vjetër...

T'u kalbën trarët,
Të mbiu bari sipër mureve;
Jazi ktheu rrugë nga centrali...
Tani s'je veç një plak i humbur,
dhëmbrënë,
Tani s'je veç një gërmë akoma
e pafshirë,
Mulli, mulli.

LIRIKË ENTUZIASTE

Sonte kam sjellë me vete
Një copë të ditës që perëndoi.

Uluni në sofër!
Të pimë për gjëzimin e fëmijëve,
Le të na venë në gjumë fëmijët:
Të puthurit e çiltër,
Dora e vogël
Syt'e pastër!...
Le të bëhen pleqtë fëmijë,
Le të bëhen fëmijët pleq!...

Sonte kam sjellë me vete
Një copë të ditës së nesërme,
Gazin e shoferëve,
Shkujdesjen e gjimnazistëve,
Heshtjen e fletoreve...
Sonte dua të mos ketë gjékundi natë.

Le të përqafohen të gjithë fëmijët
e vendit tim
Në shtratin e përbashkët të lumturisë.

Këtej kanë kaluar
Njerëzit.

Jam mësuar të jem midis tyre,
Jam mësuar të hesht dhe të qesh
Mes tyre...

MOTIV POPULLOR

1

Nga tymi i dyfeqeve
Gjithë malet mjegullohen...
Qaf' e Koçiu, moj grykë,
Katërqind e ca të vrarë,
Gjithë trima, partizanë...

2

Nga tymi i dyshemeve
Gjithë dhomat mjegullohen...
Qaf'e Koçiu, moj grykë,
S'të harrojmë kurrë, jo.
Kënga jote partizane
Seç na erdh në dasmë sot.

NJATJETA DIELL!

Popujt zgjatnin dorën në qiell
Të kapnin një copë diell
Dhe pak, fare pak
Liri.

Njatjeta, diell!
Miku më i lashtë i njerëzve.
Miku më i ri i njerëzve. —
Revolucioni s' njeh largësi,

Revolucioni — armik i natës së popujve
Revolucioni — mbi skeletin e botës
Diej të tjerë lindi...

Njatjeta, diell?

AMANETI I SKËNDERBEUT

Te bregu i detit,
Buzë Arbërisë,
Është një qipariz.
— Lidh atje ti kalin tim.

Përmbi kalë, mbi dori,
Hapeni flamurin tim.
— Lidhni, lerni shpatën
Mu në mes flamurit tim.

Era kur të fryjë,
Deti kur të nxihet,
Shihni ju flamurin
Nga ky qipariz.

Shpata ime, heshta ime
Do të tringëllijë.
Vdekja fle te shpata ime,
Turk, o turk i zi.

TE LËNDINK' E LOTVE

Kjo lëndinkë i futi thellë në gjoks
Lotët e nuseve,
Pikëllimin e heshtur
Të burrave dhe t'kuajve.

Veç ndonjëherë,
Kur bari zë e mbin buzë rrugës,
Kur gjoksi zë e zien buzë pranverës,
Lotët e varrosur të nuseve lëshojnë
tinguj,
Zilkat e karvaneve të kurbetllinjve
Nga larg sjell era...

NJË BURRI

Ti sonte u ktheve në shtëpi
Vonë
Shumë vonë.
Kishe pirë me shokët raki —
«Një gotë
Vetëm një gotë»...

Gjella të pritte e ngrohtë,
Këmish' e porsalarë —
Varur në garderobë...
Fëmijët po flinin,
Ish vonë...

E lodhur, pa gjumë,
Vetëm gruaja
Zgjuar rrinte.

Sigurisht
Të ra në kokë
E para pyetje:
«Ku ishe?»

.....
«Ku ishe?»...

RA MBRËMJA...

Ti prapë me babin ke dalë
Vërtitesh bulevardeve, mapove
Si një kukull e bukur vitrine.

Autobuzat urban
Transportojnë qindra dashuri
Në dhjetra drejtime...

Kurse ti,
Në një të tillë natë
«Familisht»
Do hash akullore
Do pish aranxhatë...

— Pashaporta ime?
Datëlindja —

1943.

Begar...
«Nuk vlen...

«Pashaportizimin s'e ka në Tiranë»...
Kështu të tha —
Babaj...

.....

Dhe,
Mbrëmja
Mbi supet tonë
Ra...

NET PROVIMESH

Drurët dhe era
Grinden.
Mesnatë.
Tani,
Im atë
Kabinën e «Skodës» mbyll
Dhe kthehet i lodhur.

«Çohu!
(Ndjej dorën e tij të akullt)
Nuk duhet të flesh»...
E shoh me sy të përgjumur
Dhe buzëqesh.

LAMTUMIRË!

Tjetër jetë,
Të tjera rregulla...
Lamtumirë
Kohë studenteske,
Net pa gjumë provimesh,
Shqetësime dashurish të lëna përgjysmë!

Po shkel në asfaltin e ditës së nesërme.
I buzëqesh nga larg
Dashurisë së re,
Horizonteve të reja,
Shokëve që akoma s'i kam njojur,
Mbrëmjeve dhe mëngjeseve të ngarkuara
Me qindra gëzime dhe shqetësime të
panjohura.

Lamtumirë
Kohë studenteske!

NESËR

Qyteti ynë i vullnetarëve,
Qyteti më i ri i botës.
Atje nuk gjen asgjë të plakur,
As njerëz, as gurë, as zemra.

Mbrëmjeve,
Kur qielli yjet derdh mbi det,
Kur vullnetarët fjetoreve çlodhen,
Unë
Mendoj, mendoj:
Qofsha gjithmonë i ri,
Vullnetar,
Banor
I qyteteve pa emër.

.....

Malet zgjatin hijet e rënda
Deri thellë në det...
Nesër,
Qytetin tonë pa emër
Dikush
Me një lapës të kuq do ta futë
Në hartën tonë ngjyrë kafe.

ADEM REKA

Nga jugu i ullinjve, i portokalleve,
Nga veriu i alpeve
Punëtorët kanë ardhur
Në kampet e pushimit...

— Ku të të kërkojnë punëtorët, Adem?

«Futuni në det,
Atje do të gjeni trupin tim,
Zérin tim,
Shpirtin tim...»

KORRJE

Fusha mbushi gjoksin me qumësht.

Kaloj

Mes grunjave

Duke përtypur kokrrat e grurit,

Duke ngjyer flokët

Me kaltërsin'e pafund të qiejve.

Kjo tokë

E thatë,

E verdhë,

E dashur

Eshtë në muajin e fundit të lindjes.

Veten e ndjej

Në mes

Të përtëritjes së jetës.

Mëngjeset futen në mushkërit'e mia

Dhe vetja më duket

E përjetshme,

E pastër,

E kulluar.

NË HEKURUDHË

Duke ecur sot nëpër Myzeqe,
Unë u bëra mik
I vullnetarëve,
I shinave,
I kapanoneve...

A s'janë këto dy shina,
Këto dy duar, këta dy sy, këto dy
fjalë
Vazhdim i të gjitha
Revolucioneve?

XHAXHAI

Im atë më ka thënë mos t'i
flas;
Më ka thënë që kur të shoh
xhaxhanë
Kokën të këthej
Mënjanë.

Si u ndanë njerëzit,
Si u grindën vlezërit!
Për një copë shtëpi,
Për një copë kusi!

Grindje të mbira
Në rrënjët e pronës.
U zunë vlezërit,
U ndanë vlezërit...
...Dhe plaka qau.

BASKETBOLLISTJA

Ç'të thonë gjyshet
Kur kthehesh mbrëmjeve nga stadiumi,
Kur hëna, si një futboll,
Mbi lagje varur rri?

Ato me vete thonë:
«Korbë, do ngelesh pa martuar;
Me djemtë e lágjes
Mos rri,
Mos luaj...»

Ti qesh...

KORIT TË PLEQVE

Rrugëve të Korçës
Kudo në mëmëdhe
Kënga juaj duket
Gjithnjë e më e re.

U mplakët...

Nëpër rrugët e Korçës
Disa nga ju mungojnë...
E megjithatë
Këngët s'mplaken.

NE, GAZETARËT

1

Gazetari — udhëtar i përjetshëm,
jabanxhi i përjetshëm;

Mik i udhëve,
Hôteleve,
revolucioneve.

2

Ne, gazetarët
Si bletët,
Në blokun e shënimeve mbledhim
Nektarin e jetës shqiptare.

Dhe e fiksojmë atë në gazetë
Që njerëzit të bëhen më të fortë,
Më të shëndetshëm,

Më të sigurt,
Më të bukur.

3

Kur kthehem në redaksi
Gishtat e trashë të punëtorëve
Godasin në trurin tim:
— Ej, gazetar,
Asgjë mos zbulkuar,
Thuaje çdo gjë troç, shtruar,
Që çdo gjë
Ta kemi kuptuar.

4

Mjerë kush i mbyllur jeton
Dhe botën e sheh
Pas xhamave të zyrës!

Burokrati — fik i thatë —
Hije bën
Në mes të arës me grurë.

Mes njerëzve të kohës sime
Un'e kuptoj se s'jam i tepërt,
Një numër në bordero
Apo një këng'e vjetëruar.

22 PRILL

1

Postieri
Gazetën e madhe të kësaj dite
(Si një copë drite)
Nëpër të çarën e derës e futi.

— Edhe sot
provokacione;
— Edhe sot
Burrat me gjyslykë
Për çarmatimin do grinden.

Por bota sot ka një festë të madhe,
Por bota sot
Në quell
Boton fotografin' e Leninit
Hipur në autoblindë.

Çuditeni?
Lenini kësaj dite del nga gazeta,

Zbret nga autoblinda
Dhe, me kapelen shuk në dorë,
Hyn në shtëpitë ulëta
Të të gjithë proletarëve
Të botës.

2

Xhaxha Lenini erdhi
Edhe në lagjen time.
Plakat fshinin sytë e mallëngjyer,
Eh, plakat qanin...
Dikush mund të pyesë
— Si është e mundur
Që një i vdekur
Të ngrihet nga mauzoleumi
Dhe flet me të gjallët
Si i gjallë?..
Por bota u mësua
Të mos çuditet me Leninin.

3

Kështu pat ardhur
(Kapelen e mbante ngjeshur në kokë)
Dhe u thosh grave që kërkonin
 bukë për kalamajtë

Se dita e nesërme do të lindte
Në çarçafët e pastër të socializmit...

Në lagjen time
Socializmi ish fjala
Më e çuditshme.
Plakat kuptonin parajsën
Dhe amëshimin e pafund të shpirtit;
Gratë thoshin se socializmi
Do të nxirrte ligje të rrepta për burrat
që dehen
Dhe që i rrabin gratë
Mbrëmjeve.

Atje,
Në këshillin e lagjes,
Shkonte Lenini është i sqaronte të gjithë
Burrat dhe gratë e shqetësuara,
Plakat
Dhe vajzat e pamartuara.

4

Kishte dhe njerëz që s'donin t'i besonin
diellit,

Ujtit që pihet pas buke,
Dritës që hyn në bodrum,
Shiut që lan vijat e trotuareve
Stuhisë së revolucionit...

Këta njerëz
I mori koha nëpër këmbë...

Në ato kohëra të çuditshme
Edhe ne
Kalamajtë «e çmendur» të lagjes
Vumë dorë
Në rrötën e karros--histori.

5

Vetëm një herë
Në syt'e Leninit
Ne pamë lot.
Një shoku ynë
Në fushën e aeroplanëve
Pat gjetur një bombë..
Dhe...

Lenini,
i mallëngjyer,
tha:
«Kur të kthehem në mauzolé,
Do ta marr me vete
Kujtimin e këtij arkivoli
Të pafajshëm...»

6

Kësaj dite
Lenini del nga mauzoleu...
Kapela e tij shuk
Do t'u kujtojë të gjithëve
Revolucionin.
Dhe s'do të ulet Lenini
Në kolltuqet
E shteteve.

KËNGË PËR TË BUKURËN RADIO TË VJETËR

Ne patëm një radio
Të vjetër shumë.
Duhej t'i binim në kurriz
Se kollej shpesh, se bënte zhurmë.

.....

E vjetra radio,
Ka ardhur koha
Të dalësh në pension,
Të çlodhësh nervat
Si ajo plaka që i binte ziles
Në shkollën tonë.

Erdhe në kohëra të vështira
Mes luftrave, tymeve, vrasjeve;
Në dhomën tonë hyre madhërishëm
Sikur të ishe Galileu vetë.

.....

Të kujtohen ilegalët?
Çdo mbrëmje
Pa fjetur ti, pa heshtur ti
Ata nuk vinin gjumë në sy...

Ti ishe ndërlidhësja
e të gjithë komunistëve,
E të gjithë ilegalëve,
E të gjithë popujve.

Çdo fitore a disfatë,
Çdo shpresë a rënkim,
Çdo fjalë e huaj
Nuk kishte nevojë për përkthim:
Fjalët «partizan», «gjerman», «komunist»
I kuptionin tek ne
Edhe gjyshet.

E bukura radio,
Ahere
E vërteta dhe gënjeshtra
Dilnin nga i njëjti mikrofon.
Cila ishte vallë ajo fuqi
Që të detyronte të trasmetoje me të
njejtin zë
Vdekjen dhe lindjen
E popujve, njerëzve, kombeve
Dhe kohrave?

Vëllai bleu
Një radio të re.
Ti tani ngjet me një vjehërr të
heshtur...

Në një qoshe rri menduar
Vetë,
Trishtuar.

Ç'ke?
Mos duhej të bëje më shumë?
Mos vallë s'mjaftonte të mbushje dhomën
Me gazin e fitores,
Me gazin e lindjes?

Mos kërkon të flasësh edhe ti
Për kooperativat e reja,
Për vullnetarët,
Për vajzat e malësisë
Që thyen e dogjën kanunet—shkarpa?

.....

Iku koha jote...
Megjithatë, ti e kupton
Se edhe sot gënjejnë, grinden,
Rrëzohen qeveritë mbi kurriz të popujve
Sikur të ishin lodra fëmijësh, ngrihen
prapë
Duke premtuar
E duke gënjer si djajtë.

Ti e di,
Ka dhe nga ata
Që nëpërmjet teje kërkojnë të futen
Në dhomën tonë.

Duan të na mbushin mendjen ne — të
rinjve
Se plaku ynë
Nuk është babai ynë...

Ja pse nervat
Të tendosura i ke gjithmonë...

.....

Një melodi e largët të vjen nga eteri:
Këndon Shqipëria,
Në 15 gjuhë të botës flet Shqipëria...
Dhe prapë ti,
E re dhe e fortë bëhesh.

KRUJË 65

1

Akoma s'po më njeh, Gjergj?
Jam unë

stërnipi yt.

Në rrethimin e Krujës jam plagosur
Dhe gjoks'n zemra ma rrithë fort,
Dhe gjaku më kish hipur në kokë,
Kur mendoja se liria
Mund të na ikte nga duart.

S'të kujtohet im atë?
Vërvitej nëpër kështjellë
Me nerva dhe flokë të shthurur...
Ne, brezat e palindur,

Ishim prapavija jote më e fuqishme,
Gjergj!
Ndryshe,

pa ne
Si mund të fitoje,
Si mund të fitoje pa ne, Gjergj?

Kur mbi muret e kështjellës,
 Kur nëpër fletët e ullinje
 Duken e zhduken yjet,
 Kur në Krujë
 Autobusi nga Tirana vjen plot zhurmë,
 Ti shqetësohesh kot, Gjergj!

Ato janë drita tutje Fush-Krujës,
 Nuk janë pishtarë,
 Nuk janë zjarre,
 Nuk janë turq,
 Nuk vjen askush
 Për rrithimin e Krujës...
 Ti e rrudh ballin kot, Gjergj!

Sa e bukur qenka, Gjergj,
 Të jetosh ballëhapur
 Para kohës sate:
 I hedh këmbët në tokë
 Pa pasur frikë nga askush.

Kthehesh mbrëmjeve në Krujë,
 Hotelxhiu s'të sheh me dyshim,
 Hotelxhiu të jep dhomën më të mirë
 Dhe e di se fle në shtëpinë tënde

Dhe e di se je te njerëzit e tu,
Te shqiptarët e tu.

4

Bota është akoma në luftë, Gjergj.
Kanë kaluar kaqë shëkuj
Dhe prapë
Udhëve të kombeve
Enden shuajt e pushtonjësve,
Çallmat famëkeqe të «turqve».

Unë e di,
Edhe im atë e di,
Edhe ti e di:
Cdo komb
Duhet të lindë përsëri
Skënderbeun e tij...
Kanë kaluar kaqë shekuj, Gjergj!

5

Dhe prapë
Jeta është kaq e bukur...
Sa popuj janë shuar,
Sa ushtarë kanë humbur nëpër histori
Vetëm e vetëm
Qëjeta të bëhej më e bukur,
Që liria të mbulonte gjithë botën.

Ti ndoshta s'ma kuhton dot gjuhën.
Të flas me gjuhën
E revolucioneve....

Jam unë, Gjergj,
s'më njeh?
Njeriu i një bote të re dhe të çuditshme.
Po ecë mbi gërmadhat
E kështjellës sate.

Mirupafshim në përjetësi!
Sepse atje
Do të takohemi me siguri,
Me siguri.
Dhe shtrëngona dorën fort
Sepse ne
Në luftë të ngjasim kaq shumë, Gjergj.

POEMË PËR SHOKËT

Edhe ne u värtitëm nëpër jetë
Me ëndrra të mëdha e të guximshme.

1

Kush thotë
Se Shqipëria jonë qenka e vogël?
Atdheu s'matet me kilometra katrore.
Sahara është e madhe, pa fund,
Por
Pa shokë,
 shkretëtirë.
Qindra linja telefoni duhen
Për të lidhur
Zemrat e shokëve.

2

Shtrëngoj dorën tënde,
Shok, që akoma s'të njoh;
Shqetësohem dhe gjëzohem për ty,

Mendoj për pagjumësinë dhe dashurinë
tënde.

Jam i sigurtë se edhe ti
Shqetësohesh njëlloj për mua...

3

Ne s'e morëm jetën me shaka.
Kemi detyrime,
Shumë detyrime.
Moshë jonë qënka stina
E aksioneve të mëdha.

Nuk pritëm sa të shtrohej sofra,
Të merrnim pirunin
E të thoshim:
«Mirë se ju gjetëm
O breza paraardhës!»...

4

Kush u thinj i pari?
Ti?
Jo, të gjithë.
Nëpër nervat tonë,
Si nëpër shina,
Kaluan trena të tillë hallesh:
Revizionizmi,
Blokada,
Tradhetia.

Shok, brenda vetes
 Kemi shumë pér të prishur e ndrequ;
 Shok, mos këndo më këngë dashuriçkash
 — s'është koha,

Shokë, na duhet
 Më tepér qymyr, naftë, bukë, hekur
 Dhe shokë,
 Shumë shokë.

Ku u njohëm?
 Në Bistricë?
 Në konvikt?
 Në hekurudhë?

.....

Ishim duke provuar
 Gëzimet e fitoreve të para,
 Përvojën e disfatave të para,
 Kur e kuptuam se ç'do të thotë: «shok»,
 Kur e kuptuam sejeta e shokut
 vlen më tepér
 Se jetatote...

Sikur midis nesh të kishte hyrë prona
 private,
 Ne do të kishim shumë grindje

Dhe pak, shumë pak —
Shokë.

Do të na hynte grindja brenda vetes
Kur të shikonim tjetrin mirë,
Kur tjetri të kish shtëpi, grua, fëmijë
Cigare e verë për të pirë...

8

Dhe qeshin shokët...
Në këtë botë
Nuk ka gjë më të bukur
Se buzëqeshja e shokut
Në prak të fitores.

Bromp!

Të pimë për fejesën e shokut tim,
Të pimë për fëmijët që do të na lindin,
Të pimë për miqësinë e shokëve
Që vijnë pas nesh...

9

Shok!

Unë jam i sigurtë se ti
Do të ndërtosh familjen më të lumtur
Nga të gjitha familjet
E epokave që shkuan...

U nisa prapë për udhë...
 Kjo pranver' e sivjetshme e bollshme
 erdhi.

Grunjat,
 Si gra që do të lindin,
 Kokën e ulin me turp...

Kudo gjej shokë,
 Shumë shokë.
 Nga qindra duar të bashkuara
 Ngrihet një hidrocentral.
 Nga dy duar të vetëmuara
 Mezi prashitet një kopsht i vogël —
 Personal...

Kjo pranver'e sivjetshme e bollshme erdhi.

Kush thotë
 Se Shipëria jonë qenka e vogël?
 Atdheu s'matet me kilometra katrore.
 Sahara është e madhe, pa fund,
 Por
 Pa shokë,
 shkretëtirë.

VARGJE PËR TOKËN, VARGJE PËR BUKËN

1

Erdhi koha të mbjellim.
Pranverë...

Toka bymehet,
Toka mbarset.

E ndjej: gruaja ime
Nga furra së shpejti do nxjerrë
Bukën e re — të tokës sonë
Bukën e re — të duarve tona.

Kjo është dita më e bukur
E të katër stinave...

Në sofër — atë mbrëmje,
(Kur askush s'do mungojë),
Më i nderuari i shtëpisë
Do të presë me thikë

Bukën e re...

...dhe do tē dehem i tē gjithë
Nga avulli i bukës,
Nga avulli i tokës.

2

Duke hapur toka tē reja,
Nga brinjët e Shqipërisë
Ne shkulim
Legjendën e flashtë:
 «Misér, misér!»
 «Misér, misér!»
Ky motiv i pandarë i barqeve
Ndërgjegjen shqitarit ja ndrydhte me
 darë.

3

Mbi kurri z gjetje
Edhe tokat kishin
Kanune, gjaqe, hakmarrje.
Shqiptari, për një copë tokë, tē vriste,
Ndonëse vetë toka
E shkretë dhe e thatë ishte.

4

Bukë...
Të kafshuarat e kësaj fjale
Shqipëria i ndjente po aq thellë
Sa ç'ndjente dhëmbjet e luftës.

Bukë...
Kjo fjalë —
Litar i diktateve,
Ku vareshin qeveritë,
Ku zënë fill e mbijnë perënditë.

Te kjo fjalë
Armiqtë e tu, Republikë,
Mbështetën të gjitha bateritë
E vdekjes.

5

Në sheshin e ngjarjeve
Si sorra, pas pérleshjeve,
Dolën prapë
Këto dy fraza të poshtra:
— S'keni bukë!
— Nënshtrohuni!
Duhej që ne
Të ulnim kokën
(«Fuqi e vogël»)
Dhe pér çdo shpifje të thoshim:
— Amin!
Dhe pér çdo tradhëti të buzëqeshnin:
— Amin!

6

Netve
Kuajve të Trojës
Ushqimin — shpërblim
U hedhin në grazhd...
Shqipëri! Në mes të kuajve të Trojës

Ti e pathyeshme ngele,
Si kalatë e dikurshme të Krujës.

7

Duke përtypur bukën time,
Duke hapur toka të reja,
Duke ndërtuar stacione, hekurudha, TEC-e
Unë e kuptoj se ç'do të thotë:
Liri,
Se ç'do të thotë
Të jesh i pavarur
Në mes të kuajve të Trojës.

8

Marr një copë tokë në duar:
Kjo baltë,
Kjo tokë
Eshtë diçka më tepër
Se vetëjeta.

9

E ndjej: gruaja ime
Nga furra së shpejti do nxjerrë
Bukën e re — të tokës sonë
Bukën e re — të duarve tona.

Kjo është dita më e bukur
E të katër stinave.

KJO SHOQJA IME

E mora
Dhe unë
 kartën e vullnetarëve.
Firmën
 në fund

E hodha.

Gjith' vullnetarët jan' mbledhur këtu,
Gjelbërim i kohës sime qenka sot këtu.

*

Pran' meje një shoqe mendohet.
Dikush tha se
Në aksion
S'do ketë çarçafë,
Krevate me sustë
Dhe qumësht, ah, qumësht.

«Një muaj korriku
 në plazh. . .»

«Pa halle,
Nën saçin e diellit,
Kur mizat nga vapa trullosen

Dhe njerëzit bymehen
Në ajrin e vakët...»

(hiqu prej nesh
Mendim mikroborgjez...
Në trurin tonë
Vend s'do gjesh...)

«Ah, po mami
Dhe babi
Ç' do thonë?»
«Po shokët që heshtin
Po shokët që sytë s'i ndajnë?»

Esht' gati
Mihali të flasë:
«Ç'të duhet,
moj çup'e mamasë?
Të dielave,
vërtitu Mapove
Një burrë të mirë
Një burrë të dashur
Të gjesh bulevardeve...»

(Hiqus prej nesh
Mendim mikroborgjez...
Në trurin tonë
Vend s'do gjesh.)

Por hesht dhe Mihali,
Agroni, Bujari, Thanasi
nuk flasin...

Godet mbi kokë
Gjyqi i heshtur
i shokëve...

«Po mami
dhe babi?»
«Si?

Çupa jonë
Delikate,
e bukur,
elegante

Të flejë barakave,
Të copëtohet maleve,
Të hajë kazaneve
Dhe,

ah,
si mund?

Çupa jonë e bukur
Me kazmë
(ptu!)
me kazmë

Rrëpirave të shuhet?

(Hiqu prej nesh
Mendim i kalbur —

mikroborgjez;
Në mbledhjen e vullnetarëve
Stol për t'u ulur
S'do gjesh...)

Mendohet
kjo shoqja ime...
Salla,
tavanin e verdhë
Mbi supe lëshon...

I rëndë ky gjyqi i heshtur
I shokëve...

.....

Kur dolën nga mbledhja
Trotuaret e lagura
Me natë
dhe shi
Dhe dritë neonesh
Po bënин bisedën e mbrëmjes...

Ne, vullnetarët,
Fcnim dhe mendonim
Se si
Na lindën ne
rrugët e reja
Dhe ne
do lindnim
Të tjera
Rrugë të reja...

MBRËMJA, SHTËPIA DHE UNË

1

Kur të fillojnë yjet të çapiten
Mbi kalldrëmet e nxehura nga dielli që
perëndoi,
Do të vij dhe unë një mbrëmje,
Një mbrëmje dhe unë do të vij
Të ulem në prak të shtëpisë.

Macet do të ndiqen çative
Se pranvera do të ketë hyrë në gjoksin e
lagjes.
Dhe erë djersë do të bien udhët,
Dhe burrat e heshtur, si gjithmonë,
Të heshtur do të kthehen shtëpive.

2

Do të vij një mbrëmje të bisedoj praqeve
Me gratë e lagjes, me plakat, me pleqtë.

Atë mbrëmje do të ulem
Në sofrën e gërryer nga lugët, fjalët dhe
bërrylet.

Dikur nata shtrihej pas perdeve
 Si simbol i errët
 I vargjeve të Migjenit.
 Shtrihej nata mbi sofër, mbi rrugë — kudo
 Dhe vriste bukurinë e sofrës, të bukës, të
 heshtjes;
 Vriste nata
 Bukurinë e çarçafeve
 Në natën e parë të martesës...

Në të tilla net
 Nënënat tonë u shitën.
 Të dhëmbshurat nëna, zemërbardhat
 Gjithë dashurinë e ndrydhur
 Për burrin, për botën, për jetën
 E derdhën mbi ne —
 Bijtë.

Atë mbrëmje do të pi ujë
 Me bardhakun që blemë dikur te poçaxhiu i
 lagjes.
 ...Kur thyeja bardhakun në çesmë,
 Plaku kafshonte çipin e buzës
 Se i vinte keq të më rrihte
 Dhe prapë më rrihte...

Poçaxhiu i lagjes
Kthehej çdo mbrëmje i dehur;
Kur dehej,
Këndonte këngë të ndyra,
Gruan e rrihte,
Dhe si teneqe e vjetër, e ndryshkur — kur
kthehej
Në lagje zhurmë sillte.

5

Bota ecën,
Ecën.
Ndofta prandaj vjen kaq shpejt pranvera,
Ndofta prandaj rilind kaq shpejt bota.

Siç del mëngjesi me diell nga kapot'e natës,
Dolëm nga kjo botë e vjetër
Më një triskë të kuqe rinie në xhep të
xhaketës,
Me një besim të patundur revolucioni
Në zemër.

6

Atë mbrëmje
Kur të kthehem unë në shtëpi
Gjithë lagjja do të ketë festë...
Im më do të ketë veshur
Fustan të ri...

Në mur do të kenë varur
Një kopertinë nga «Ylli»...
Dhe dhoma ime — me siguri —
Do të bjerë erë mollë.

Do të më pyesin të gjithë
Ku kam qenë,
Ç'kam ndërtuar...
Im atë në një qoshe rri serioz,
Diçka në kokë bluan...

«M'u bë djali
Për tu martuar...
Ah, moj plakë,
Iku koha jonë,
Jeta e tyre
Sapo ka filluar»...

7

Atë natë
Të tjerë djem
Do të këndojnë udhëve të lagjes
Këngët e gëzuara të mëngjezeve...

Mua dhoma do më duket
Shumë e ngushtë...

«Sot, tē parat shina hodhëm.
Më shkruan motra nē letër
«Vetja më duket e fortë,
Sikur jam një tjetër...»

U rrit dhe motra,
Shkoi nē hekurudhë...
Në rrugën e revolucionit
Ajo po ec ashtu si ti
Ashtu si unë...

8

Atë mbrëmje
Do tē pimë raki dhe do tē hamë mish tē
pjekur,
Lakror me petë tē hollë,
Ashtu si c'di ta bëjë vetëm nëna ime
Me ato duart e fishkura
Si degë pemësh nē vjeshtë.

Miellin, rakinë, mishin e pjekur
Do ta sjellë dajua nga fshati;
Do tē vijë dhe ai atë mbrëmje tē flasë
Për kooperativën, për grurin, . .

Dajua do tē mbështesë bërrylet nē sofër.
Mua do më duket
Sikur dy kodra kanë hyrë nē dhomë,
Ai do tē qeshë fort.

Mua do më duket
Sikur tavani thërmohet nga gazi.

9

...dhe do mendojmë
Se jeta është kaq e bukur.
Nuk është lehtë të mbjellësh patate,
Të hedhësh shina mbi trase,
Të shkosh gjith ditën pas qeve
Të ndërtosh nga e vjetra
«Me forcat e tua»
Një botë të re...

Dhe ja, vjen djali.
Ke gotën,
Plakën,
Gëzimin e së nesërmes
Dhe jeta të duket
Akoma më e bukur...

10

Ndërsa unë pi raki,
Nëpër mbrëmje shpalosen udhë të reja
Që presin mëngjesin, dhe këpucët e mia.

Drejt horizontit do jet' zgjatur akoma
traseja

E gjelbër, komuniste
Më ngjallet Malsia.
Të tjera mure, të tjera lagje,
Të tjera qëllime të ardhshme
Më prishin gjumin, netve
Dhe jetën ma bëjnë akoma më të bukur.

11

Udhë, udhë...
Kush mund t'i dojë vallë
Më shumë se unë dhe shokët e mi,
Më tepër se Shqipëria,
Udhët e reja që shpalosen mëngjeseve?

Udhë, udhë...
Unë pashë
Si mbërtheheshin në gjoks të Shqipërisë
Digat e hidroçentraleve;
Unë pashë
Si thërmohoj tokë
Nga nervi i gjeologut;
Unë pashë
Si thyheshin kanunet e Dukagjinit
Nga duart e njoma
Të bashkënxënëseve të mia.

...prandaj do më duket dhoma
Shumë e ngushtë.

Kur isha i vogël
 Në këtë dhomë rrija vetëm
 Dhe mundohesha ta merrja me mend
 Sa e madhe ishte bota...

Atë mbrëmje
 Do t'i kujtoj të gjitha...
 Pastaj do t'u flas pleqve për vajzën që
 do t'u bëhet nuse,
 Por që emrin e ka
 muhamedan.
 Të shkretët pleq do të shkojnë të flenë
 Pa u ngrindur — jo si gjithnjë,
 Ftohtë — jo si gjithnjë
 të pikelluar jo si gjithnjë.

Të mërzitur
 Do thonë:
 — Fli o plakë
 fli!
 — Fli, o burrë,
 fli!
 Por gjumi, unë dhe mbrëmja
 Do t'u qëndrojnë mbi kokë.

TREGUESI I LËNDËS

	Faqe
Sikur	3
Aleksandër Moisi	4
Babait	6
Këngë djepi e kënduar në dy kohë të ndryshme	7
Pranverë	9
Bramka	10
Mirë mëngjerez	11
Stërnipërve	12
Koncert	13
Viti i ri 1967	14
Mulliri i vjetër	15
Lirikë entuziaste	17
Motiv populor	19
Njatjeta diell!	20
Amaneti i Skënderbeut	21
Te lëndink' e lotve	22
Një burri	23
Ra mbrëmja	24
Net provimesh	26
Lamtumirë!	27
Nesër	28
Adem Reka	29

Korrje	30
Në hekurudhë	31
Xhaxhai	32
Basketbollistja	33
Korit të pleqve	34
Ne, gazetarët	35
22 Prill	37
Këngë për të bukurën radio të vjetër	41
Krujë 65	45
Poemë për shokët	49
Vargje për tokën, vargje për bukën	54
Kjo shoqja ime	58
Mbrëmja, shtëpia dhe unë	62